



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 16

Prishtinë, më 7 shtator 2011, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Gëzim Kelmendi, Nazane Breca.

Mungoi: Aurora Bakalli.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Shefki Kastrati- NDI, Ukë Gashi- Presidenca e Kosovës, Lejla Selimi- OSBE, Qëndresa Ismaili- praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 29.07. 2011;**
- 3. Azhurnimi i planit të punës së Komisionit ;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 29.07. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e datës 29 korrik 2011.

3. Azhurnimi i planit të punës së Komisionit

Time Kadriaj- Tha se ekziston nevoja e plotësimit të planit të punës së Komisionit, për shkak të vonesës së projektligjeve nga Qeveria. Nuk po e kuptoj se përse janë vonuar këto projektligje, sidomos Projektligji për shëndetësinë, i cili është plotësim- ndryshim dhe nuk duket të ketë ndonjë implikim të veçantë financiar.

Flora Brovina- Konstatoi se gjatë muajit shtator parashihen të vijnë për shqyrtim projektligje shumë të rëndësishme, siç është Projektligji për shëndetësinë dhe Projektligji për sigurimet shëndetësore dhe një varg ligjesh të tjera nga fusha e mirëqenies sociale. Duhet të përcaktohem se cilin ligj do ta monitorojmë për sesionin vjeshtor. Nuk zbatohet Ligji për punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe kemi vërejtur se as Kuvendi nuk e ka bërë një gjë të tillë. Po ashtu, janë evidentuar shkelje të Ligjit të punës, sepse e dimë se me atë ligj, nëna që e lind fëmijën detyrohet që të jetë në pushim të lehonisë së paku për 6 muaj. Heqjen dorë nga pushimi i lehonisë e kemi vërejtur edhe te disa zyrtarë të lartë qeveritarë, të cilët për ambicie të veta, po e shkelin këtë Ligj dhe ligje të tjera.

Fikrim Damka- I informoi anëtarët e Komisionit se, sipas vendimit të Qeverisë, është tërhequr nga strategjia legjislative 2011, Projektligji për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve publike të punësimit në Kosovë. Sipas informatave të mia, Projektligji për shëndetësi dhe Projektligji për sigurime shëndetësore do të vijnë në Kuvend brenda muajit shtator.

Salihe Mustafa- Tha se duhet të përcaktohem për monitorim të një ligji dhe pastaj do të shohim se si do të ecën puna me shqyrtimin e ligjeve të tjera që do të na vijnë. Projektligji për shëndetësi është plotësim- ndryshim, ndërsa ka ndryshime të mëdha në tërë sistemin shëndetësor dhe, si i tillë, ka shumë për t'u punuar rreth tij.

Gëzim Kelmendi- Tregoi se në bazë të programit të PVPE, parashihet se tash duhet të fillojë monitorimi i Ligjit për Inspektoratin e Punës.

Sasha Gjokiq- Tha se monitorimi i Ligjit të punës është i rëndësishëm, sepse edhe në komunitetin tim ka shumë probleme në fushën e punësimit, dhe lidhur me këtë, një punë e tillë profesionale e Komisionit do të ishte e mirëseardhur.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që të miratojë planin e azhurnuar të punës dhe po ashtu vendosi që të formojë grupin e punës për monitorimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës në këtë përberje: Nazane Breca-kryesuese, Gëzim Kelmendi dhe Time Kadriaj.

4. Të ndryshme

Flora Brovina- E informoi Komisionin për mbledhjen dhe punën e grupit të punës për Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre. Ju lus që t'i sjellni propozimamendamentet për këtë Projektligj, sepse ky Projektligj ka nevojë të plotësohet. Duhet të përcaktohem edhe për ekspertin që do të na ndihmojë në këtë Projektligj.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që si ekspert për ndihmë në amendamentimin e këtij Projektligji t'i angazhojë Mazllum Baraliun dhe Valon Muratin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka